

BULETIN INFORMATIV

Aktivitetet e muajit Mars 2026

www.cp-project.al info@cp-project.al



Mbledhja e tretë e Këshillit Drejtues të Programit SCPA me palët e interesuara

Më 4 mars 2026, Programi SCPA organizoi Takimin e tretë të Këshillit Drejtues, duke bashkuar palët kryesore të interesuara institucionale të përfshira në zbatimin e aktiviteteve të programit.

Takimi u bashkë kryesua nga Z. Dhimitraq Ziu, Drejtor i Departamentit të Rendit dhe Sigurisë Publike në Policinë e Shtetit, dhe Z. Erik Illes, Zëvendës Shef i Misionit dhe Shef i Bashkëpunimit për Zhvillim në Ambasadën e Suedisë në Shqipëri.

Në takim morën pjesë drejtues të Policisë së Shtetit në fushat e rendit e sigurisë publike dhe trajnimit policor, si dhe përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencisë së Mbështetjes së Shoqërisë Civile dhe Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë.

Në fjalën e tij, Z. Ziu theksoi angazhimin e vazhdueshëm të Policisë së Shtetit për zbatimin e filozofisë së policimit në komunitet dhe forcimin e bashkëpunimit me komunitetet për të rritur sigurinë publike.

Ai theksoi aktivitetet e vazhdueshme të mbështetura nga programi në fusha të tilla si zbatimi i policimit në komunitet,

përmirësimi i statistikave të rendit publik, siguria rrugore, lufta kundër dhunës në familje, ndërgjegjësimi i rinjve në shkolla dhe përmirësimi i shërbimeve policore bazuar në gjetjet e anketave të zhvilluara nga programi.

Erik Illes nënvizoi mbështetjen e gjatë të Suedisë për Policinë e Shtetit në forcimin e sigurisë publike dhe policimit në komunitet, duke vënë në dukje rëndësinë e përshtatjes së rezultateve të programit për të mbështetur përparimin e Shqipërisë drejt anëtarësisë në Bashkimin Evropian.

Ansi Shundi, Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit SCPA, prezantoi progresin e programit gjatë semestrit të tretë dhe aktivitetet e planifikuara për periudhën e ardhshme.

Anëtarët e Komitetit Drejtues diskutuan rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërinstitucional dhe miratuan unanimisht Raportin e Progresit të programit, duke konfirmuar angazhimin e tyre për bashkëpunim të mëtejshëm në forcimin e sigurisë publike në Shqipëri.

AKTIVITETET KRYESORE:

- ◆ Mbledhja e tretë e Këshillit Drejtues të Programit SCPA me palët e interesuara
- ◆ Trajnimi i Patrullës së Përgjithshme dhe Stafit të SKK për Zbatimin e Policimit në Komunitet – Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë
- ◆ Seminar mbi “Përmirësimin e Sistemit të Statistikave të Rendit Publik”
- ◆ Aktivitet nga Skema e Granteve – KVSP dhe Sistemi i Matjes së Sigurisë në Komunitet – Shkodër
- ◆ Aktivitet nga Skema e Granteve – Trafikimi i Qenieve Njerëzore – Fier
- ◆ NSPK-të për edukimin vazhdojnë punën ndërgjegjësuere në shkolla



Trajnimi i Patrullës së Përgjithshme dhe Stafit të SKK për Zbatimin e Policimit në Komunitet – Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë



Në datat **11-13 mars, 18-20 mars dhe 24-26 mars 2026**, grupi i parë grupi i dytë dhe grupi i tretë i **Oficerëve të Patrullës së Përgjithshme** dhe personelit të **Sallës së Komandës dhe Kontrollit të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë** morën pjesë në një trajnim të organizuar nga **Ekipi i Menaxhimit të Programit SCPA**, i zhvilluar në ambientet e DVP Lezhë. Numri i pjesëmarrësve ishte në total 66 Punonjës policie

Gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit u njohën si me pjesën teorike ashtu edhe me ushtrimet praktike dhe me punën në grup, duke u fokusuar në

filozofinë e Policimit në Komunitet dhe zbatimin e elementeve të saj në punën e përditshme të oficerëve të Policisë së Shtetit.

Gjithashtu, atyre iu prezantuan situata/ushtime praktike për t'u trajtuar dhe zgjidhur prej tyre teksta punuan në grup me synimin për të siguruar masat që duhen marrë në mënyrë proaktive për zbatimin e elementeve të Policimit në Komunitet.

Vëmendje e veçantë iu kushtua trajtimit të rasteve të Dhunës në Familje si në aspektin teorik ashtu

edhe atë praktik. Me qëllim për të ofruar module trajnimi gjithëpërfshirëse, ekipi i Programit SCPA bashkëpunoi me Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, ekspertët e së cilës ofruan leksione ndërvepruese mbi luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Praktikat më të mira të BE-së për zbatimin e filozofisë së PK u ndanë e shkëmbyen me oficerët e PSH. Në përfundim të këtij trajnimi, oficerët e PSH arrijnë të përmirësojnë njohuritë dhe kapacitetet e tyre për zbatimin e Policimit në Komunitet. oficerëve të Policisë së Shtetit,

Seminar mbi Përmirësimin e Sistemit të Statistikave të Rendit Publik



Më **11 mars 2026**, Ekipi i Menaxhimit të Programit SCPA (EMP), në bashkëpunim me përfaqësues të Policisë së Shtetit, organizoi sesionin e pestë të serisë së seminareve me titull "**Përmirësimi i Sistemit të Statistikave të Prodhuara dhe të Përdorura nga Strukturat e Rendit Publik**".

Anëtarët e Grupit të Punës vazhduan të punojnë ngushtë me qëllim krijimin e

sistemit të statistikave të rendit dhe sigurisë publike.

Gjatë kësaj seance, pjesëmarrësit u përqendruan në të dhënat e dobishme për policinë duke shqyrtuar formularët përkatës të statistikave dhe duke ndarë përvoja dhe informacione mbi përmirësimin e përmbajtjes së formularëve të statistikave të rendit publik.

Grupi i Punës do të vazhdojë bashkëpunimin me qëllim rritjen e saktësisë, besueshmërisë, krahasueshmërisë dhe përdorimit efektiv të statistikave të rendit dhe sigurisë publike.

Aktivitet nga Skema e Granteve – KVSP dhe Sistemi i Matjes së Sigurisë në Komunitet – Shkodër



Më **10 mars 2026**, në Prefekturën e Qarkut Shkodër u zhvillua një takim pune në kuadër të Programit SCPA, në bashkëpunim me organizatën “Gruaja tek Gruaja”. Takimi, i drejtuar nga Prefektja e Qarkut dhe ekspertja e programit, kishte në fokus prezantimin e kuadrit ligjor dhe praktik për funksionimin e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP). Pjesëmarrësit përfshinë përfaqësues të bashkive të qarkut, Policisë së Shtetit, Policisë Bashkiake, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve vendore. Diskutimet u përqendruan në rolin e

prefektit dhe bashkive, përbërjen e KVSP-ve dhe rëndësinë e koordinimit ndërinstitucional për çështjet e sigurisë në komunitet. Ky aktivitet u konsiderua një hap konkret drejt funksionalizimit efektiv të KVSP-ve dhe forcimit të policimit në komunitet.

Më **18 mars 2026**, në Bashkinë Vau i Dejës u mbajt mbledhja e parë funksionale e KVSP-së pas formimit të tij në dhjetor 2025. Takimi përfshiu përfaqësues nga policia, arsimi, shëndetësia, emergjencat civile, autoritetet ushqimore, zonat e mbrojtura, si dhe organizata “Gruaja

tek Gruaja”. Diskutimet u bazuan mbi rezultatet e Sistemit të Matjes së Sigurisë në Komunitet (SMSK), të cilat evidentuan shqetësime si prania e personave nën ndikimin e alkoolit në hapësira publike dhe frika e qytetarëve për pasurinë e tyre. U vendos që hapat e mëtejshëm të përfshijnë analizë të detajuar të rezultateve, hartimin e planeve konkrete për adresimin e problematikave dhe përfshirjen aktive të komunitetit në vendimmarrje. Ky takim vendosi bazat për një bashkëpunim të strukturuar dhe të qëndrueshëm ndërmjet aktorëve lokal.

Aktivitet nga Skema e Granteve – Trafikimi i Qenieve Njerëzore – Fier



Më **11 mars 2026** u zhvillua në Shkollën e Bashkuar Grabian takimi informues dhe ndërgjegjësues mbi rreziqet e trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve në komunitetet rome dhe egjiptiane. Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit “Skuadra e Sigurisë Publike 2 – Partner për një komunitet të sigurt”, pjesë e Skemës së Granteve të Programit SCPA.

Takimi u organizua në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, në kuadër të planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga Komiteti i Palëve të Konventës së Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve

Njerëzore, për forcimin e masave kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Qëllimi i takimit ishte rritja e ndërgjegjësimit të nxënësve, prindërve dhe mësuesve mbi rreziqet e trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve, veçanërisht në komunitetet rome dhe egjiptiane, si dhe ofrimi i këshillave për mbrojtjen dhe raportimin e rasteve të dyshuara.

Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, punonjës të shërbimit social në bashkinë Divjakë, Oficerja e Sigurisë dhe përfaqësues të shërbimit psikosocial në shkollë, si dhe prindër dhe fëmijë të komunitetit.

Gjatë takimit u trajtuan disa tema të rëndësishme që lidhen me ndërgjegjësimin dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Pjesëmarrësit u informuan mbi çfarë është trafikimi i qenieve njerëzore dhe format në të cilat ai mund të shfaqet, si dhe mbi rreziqet që ai paraqet për fëmijët dhe të rinjtë. Gjithashtu u theksua roli i rëndësishëm që kanë familja dhe komuniteti në parandalimin e këtyre fenomeneve. Gjatë diskutimit u trajtua edhe mënyra e identifikimit të rasteve në rrezik, rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet shkollës dhe komunitetit, si dhe procedurat dhe mënyrat se si mund të raportohen rastet e dyshuara.

NSPK-të për edukimin vazhdojnë punën ndërgjegjëse në shkolla



Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrisë së Brendshme, si dhe në përputhje me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1076, datë 14.09.2022, "Për zbatimin e Programit 'Siguria e të Rinjve' në shkollat 9-vjeçare publike dhe jo publike," Ndhmës Specialistët e Policimit në Komunitet për Edukimin dhe Punën me të Rinjtë kanë vijuar me përkushtim aktivitetet e tyre gjatë muajit **mars, 2026**.

Objektivi kryesor i këtij programi është ngritja e ndërgjegjësimit të të rinjve kundër përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogës.

Në kuadër të këtij programi, NSPK-të kanë bashkëpunuar ngushtësisht me koordinatoret vendore të Zyrave Arsimore Vendore (ZAV), duke hartuar së bashku një kalendar të detajuar mujor për zhvillimin e temave në shkollat 9-vjeçare që ndodhen brenda zonave të tyre policore. Gjatë muajit mars, fokusi i veçantë ka qenë të

temat e ndërgjegjësimit kundër përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogës të cilat përbëjnë prioritetet në edukimin e fëmijëve për mbrojtjen e jetës dhe parandalimin e rreziqeve të mundshme në përditshmërinë e tyre.

Gjithashtu, janë trajtuar edhe tema të tjera që lidhen me edukimin qytetar, në bazë të kërkesave të komunitetit arsimor dhe situatave specifike të secilës zonë.

Përmes platformës online të monitorimit të aktiviteteve, është vërejtur një angazhim i shtuar nga ana e NSPK-ve që operojnë në komisaritet e qyteteve **Tiranë, Shkodër, Lezhë, Durrës Fier, Lushnje, Korçë, Pogradec, Berat, Permet, Kukës, Gramsh, dhe Sarandë,**

Këto njësi kanë treguar një intensitet të lartë pune, duke realizuar takime të shumta dhe duke shpërndarë materiale ndërgjegjëse përmes rrjeteve sociale dhe forumeve online.

Në total, janë postuar **185** materiale dhe aktivitete që janë parë në mënyrë

interaktive nga **2093** përdorues, duke dëshmuar një interes të madh nga publiku.

Për më tepër, janë regjistruar gjithsej **48** komente në këto postime, të cilat në pjesën më të madhe kanë qenë pozitive, përshëndetëse dhe vlerësuese për punën dhe përkushtimin e treguar nga specialistët e Policisë së Shtetit.

